



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.76

1 korrik

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.393, datë 19.5.2010	Për hapjen e programeve të reja të studimit, pranë shkollës së lartë private “Illyria”, Tiranë	3997
Vendim i KM nr.398, datë 26.5.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, të ndryshuar	3998
Vendim i KM nr.399, datë 26.5.2010	Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë	4008
Vendim i KM nr.400, datë 26.5.2010	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Fleti 1” dhe “Fleti 2”, dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë	4011
Vendim i KM nr.401, datë 26.5.2010	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Kaskada e hidrocentraleve në lumin Seta”, dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë	4011
Vendim i KM nr.402, datë 26.5.2010	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Truen”, dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë..	4012
Vendim i KM nr.403, datë 26.5.2010	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Opar 1”, dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë..	4013

Vendim i KM nr.405, datë 26.5.2010	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të një sipërfaqeje nga trualli funksional i pronës nr.231 “Shtëpia e pushimit të ushtarakëve”, në Plepa, Durrës, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”	4013
Vendim i KM nr.406, datë 26.5.2010	Për hapjen e programeve të reja të studimeve në shkollën e lartë private “Universiteti Polis”, Tiranë	4016
Vendim i KM nr.407, datë 26.5.2010	Për hapjen e filialit të shkollës së lartë private “Kristal”, në qytetin e Gjirokastrës	4017
Vendim i KM nr.408, datë 26.5.2010	Për hapjen e programeve të reja të studimeve në shkollën e lartë private “Ufo University”, Tiranë	4018
Vendim i KM nr.409, datë 26.5.2010	Për një shtesë fondi në buxhetin e të vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z. Zef Prendi, në Spitalin Amerikan, Tiranë	4019
Vendim i KM nr.411, datë 19.5.2010	Për kriteret, procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit	4019
Vendim i KM nr.412, datë 26.5.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim, transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Busa” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Strelca 1”, “Strelca 2” dhe “Strelca 3”	4022
Vendim i KM nr.474, datë 30.6.2010	Për rritjen e pensioneve.....	4027
Vendim i KM nr.476, datë 30.6.2010	Për rritjen e pensioneve suplementare të ushtarakëve, të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të trajtimeve të veçanta financiare	4029
Vendim i KM nr.477, datë 30.6.2010	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.1114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”	4031

VENDIM
Nr.393, datë 19.5.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË
LARTË PRIVATE “ILLYRIA”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në shkollën e lartë private “Illyria”, Tiranë, të programeve të reja të studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

- a) Financë-kontabilitet;
- b) Administrim biznesi.

2. Këto programe studimi të ciklit të parë realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tri) vite akademike. Në përfundim të programit të studimit lëshohet “Diplomë e niveli të parë” (DNP), në:

- a) Financë-kontabilitet;
- b) Administrim biznesi.

3. Hapjen, në shkollën e lartë private “Illyria”, Tiranë, të programeve të studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

- a) Shkenca politike;
- b) Drejtësi;
- c) Administrim biznesi;
- ç) Menaxhim bankar;
- d) Marrëdhënie ndërkombëtare.

4. Këto programe studimi të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të programit të studimit lëshohet “Diplomë e niveli të dytë” (DND) në:

- a) Shkenca politike;
- b) Drejtësi;
- c) Administrim biznesi;
- d) Menaxhim bankar;
- e) Marrëdhënie ndërkombëtare.

5. Hapjen, në shkollën e lartë private “Illyria”, Tiranë, të programeve të studimit të ciklit të tretë, “Master i nivelit të dytë” (MND), në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

- a) E drejtë civile;
- b) E drejtë penale;
- c) E drejtë publike.

6. Këto programe studimi të ciklit të tretë realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1 (një) vit akademik. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diploma “Master i nivelit të dytë” (MND) në:

- a) E drejtë civile;
- b) E drejtë penale;
- c) E drejtë publike.

7. Shkolla e lartë private “Illyria”, Tiranë, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 1, 3 e 5 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

8. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

9. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.398, datë 26.5.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1, DATË 10.1.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROKURIMIN PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin “Rregullat për prokurimin publik”, që i bashkëlidhet vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I “Organizimi i prokurimit publik”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Pas shkronjës “e” të pikës 2 “Prokurimi i përqendruar dhe organi qendror blerës”, shtohet shkronja “ë”, me këtë përmbajtje:

“ë) Pika 2 nuk zbatohet në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale kur autoritetet kontraktore janë ente private.”.

b) Në pikën 3 “Buletini i Njoftimeve Publike”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i) Në paragrafin e parë të shkronjës “a”, pas fjalës “...boton...” shtohet fjala “...elektronikisht...”;

ii) Në paragrafin e tretë të shkronjës “b”, pas fjalëve “...boton atë ...” shtohet fjala “...elektronikisht...”;

iii) Shkronja “c” “Botimi i njoftimeve të kontratës”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Botimi i njoftimeve të kontratës

Autoriteti kontraktor dërgon në APP për botim në Buletinin Elektronik të Njoftimeve Publike dhe publikim në faqen e internetit të APP-së çdo njoftim për procedurën e hapur, të kufizuar, me negociim me shpallje paraprake të njoftimit, kërkesë për propozim, konkurs projektimi, si dhe shërbime konsulence për kufirin e ulët monetar. Njoftimi dërgohet në formë elektronike (CD/flopi disk/e-mail).

Në procedurat e prokurimit, që zhvillohen me mjete elektronike, hedhja e njoftimit të kontratës në sistem bëhet nga vetë autoritetet kontraktore. Shpallja e njoftimit në faqen e internetit të APP -së do të bëhet publike ditën e nesërme të punës nga dita e hedhjes së njoftimit në sistem.

Një përmbledhje e njoftimit të kontratës për kufirin e lartë monetar do të botohet edhe në të paktën një gazetë ndërkombëtare, me shpërndarje të gjerë në Europë.”.

iv) Paragrafi i parë i shkronjës “ç” “Botimi i njoftimit të fituesit dhe njoftimi i kontratës së lidhur”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Autoriteti kontraktor dërgon për botim në Buletinin Elektronik të Njoftimeve Publike dhe për publikim në faqen e internetit të APP-së njoftimet e fituesit, në përputhje me nenin 58 të LPP-së, si dhe njoftimin e kontratave të lidhura, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës. Në procedurat e prokurimit që zhvillohen me mjete elektronike, hedhja në sistem e njoftimit të 3998

fituesit dhe njoftimi i kontratës së lidhur bëhen nga vetë autoritetet kontraktore. Shpallja e njoftimit të kontratës së lidhur në faqen e internetit të APP –së do të bëhet publike ditën e nesërme të punës, nga dita e hedhjes së njoftimit në sistem. Shpallja e njoftimit të fituesit, në faqen e internetit të APP –së, do të bëhet publike pas 7 (shtatë) ditësh, nga dita e hedhjes së njoftimit në sistem. Kur ky afat përkon me ditë pushimi, njoftimi bëhet publik ditën pasardhëse të punës.”.

v) Në shkronjën “d” “Raporti i realizimeve të prokurimit publik” fjalët “... veprimtarive të prokurimit ...” zëvendësohen me “...prokurimeve të realizuara...”.

2. Në kreun II “Rregulla të përgjithshme të prokurimit”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Në fund të shkronjës “a” të pikës 1 “Kufijtë monetarë”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Të njëjtët kufij monetarë zbatohen edhe për kontratat sektoriale.”.

b) Në paragrafin e dytë të shkronjës “b” të kësaj pike, pas fjalëve “...Për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare...” shtohen fjalët “...dhe përfaqësitë tona diplomatike...”.

c) Në fund të shkronjës “b” të pikës 2 shtohet ky paragraf:

“Në llogaritjen e vlerës së fondit limit, kur do të lidhet marrëveshje kuadër, do të përfshihet vlera e të gjitha kontratave që mund të lidhen brenda afatit të kësaj marrëveshjeje.”.

3. Në kreun III “Dokumentet e tenderit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në paragrafin e parë të shkronjës “a” të pikës 1 “Dokumentet standarde të tenderit”, fjalia e parafundit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentet standarde.”.

b) Në shkronjën “b”, pas nënparagrafit të dymbëdhjetë shtohen këta dy nënparagrafë:

“- Kushtet e marrëveshjes kuadër;

- Formulari për deklarimin e konfliktit të interesit.”.

c) Në pikën 2 “Informacion i përgjithshëm”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i) Në fjalinë e parafundit të shkronjës “a” “Njoftim i kontratës”, dhe në fjalinë e fundit të shkronjës “b” “Ftesa për ofertë”, pas fjalëve “... kriteret e shpalljes së fituesit; ...” shtohen fjalët “... kushtet e marrëveshjes kuadër;...”.

ii) Shkronja “ç” “Formulari i ofertës”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) Ky formular përmban vlerën e ofertës.

Formularit të ofertës i bashkëlidhet një listë e hollësishme çmimesh, që përbëjnë çmimin e plotë.”.

iii) Paragrafi i dytë i shkronjës “e” “Formulari i sigurimit të ofertës”, riformulohet, si më poshtë vijon:

“Ofertuesit ose kandidatët e kualifikuar duhet të paraqesin sigurimin e ofertës, në vlerën 2% të vlerës limit, të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.

Tërheqja e ofertave nga ofertuesit e klasifikuar i dyti e me radhë, pas klasifikimit nuk ndikon në vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së prokurimit nga autoriteti kontraktor.”.

iv) Në fund të shkronjës “e” shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ky formular nuk është i detyrueshëm të përdoret nga autoritetet kontraktore, në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale.”.

v) Paragrafi i dytë i shkronjës “ë” “Formulari i sigurimit të kontratës”, shfuqizohet dhe në fund të kësaj shkronje shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ky formular nuk përdoret nga autoritetet kontraktore, në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale.”.

vi) Fjalia e dytë e shkronjës “f” “Formulari i njoftimit të fituesit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Ky njoftim i dërgohet edhe APP-së për t’u botuar në Buletinin Elektronik të Njoftimeve Publike dhe publikim në faqen e internetit të APP-së, në përputhje me nenin 58 të LPP-së.”.

- Në fund të kësaj shkronje, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Njoftimi i fituesit nga marrëveshja kuadër duhet të përmbajë: referencën e procedurës, emrin dhe adresën e saktë të ofertuesit/ofertuesve të shpallur fitues; përshkrimin e punëve /mallrave /shërbimeve, që do të blihen; kohëzgjatjen e marrëveshjes kuadër.”.

vii) Në paragrafin e parë të shkronjës “g”, pas fjalëve “... për të mundësuar ...” shtohen fjalët “ ... shpalljen në formë elektronike në faqen e internetit të APP-së...” dhe në fund të kësaj shkronje, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Autoriteti kontraktor nuk duhet të publikojë apo të dërgojë për publikim kontratën fituese për një kontratë të lidhur nga një marrëveshje kuadër.”.

viii) Pas shkronjës “h” shtohen shkronjat “i” dhe “j”, me këtë përmbajtje:

i) Marrëveshja kuadër: Marrëveshja kuadër përmban formën e marrëveshjes, listën e mallrave/shërbimeve, termat dhe kushtet e blerjes së mallrave/shërbimeve, afatin e livrimit, çmimin.

j) Formulari i deklarimit të konfliktit të interesit.

Ky formular garanton autoritetin kontraktor se ofertuesit/kandidatët nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit. Ai përmban të dhënat personale të ofertuesit/kandidatit dhe të personave që konsiderohen si persona në konflikt interesi, sipas ligjit.”.

ç) Paragrafi i fundit i nënndarjes “i” të shkronjës “c” “Kontratat e shërbimeve” të pikës 3, “Informacione të veçanta”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Nuk lejohet përcaktimi i kufijve monetarë skualifikues, të cilët tejkalojnë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Si rrjedhim, një operator me bilanc ekonomik negativ, për një periudhë trivjeçare, mund të shërbejë si tregues për paaftësinë e këtij operatori ekonomik për përmbushjen e kontratës.”.

4. Në fund të kreu IV “Llojet dhe përzgjedhja e procedurave”, shtohen krerët IV/a dhe IV/b, me këtë përmbajtje:

“KREU IV/A PROKURIMI I KONTRATAVE SEKTORIALE

1. Autoritetet kontraktore që kryejnë procedura për kontratat sektoriale:

a) Autoritetet kontraktore që kryejnë veprimtari në sektorët e shërbimit uJOR, energjetik, transportit dhe të atij postar do të zbatojnë dispozitat e këtij kreu dhe të rregullave të përgjithshme për prokurimin publik, pavarësisht nëse ato operojnë në bazë të një të drejte ekskluzive apo të veçantë.

b) Këtyre rregullave mund t’u nënshtrohen edhe entet private. Në këtë rast, enti privat duhet, detyrimisht, të kryejë veprimtari në sektorët e shërbimit uJOR, energjetik, transportit dhe të atij postar mbi bazën e një të drejte të veçantë ose ekskluzive të lëshuar nga një autoritet kompetent i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet çdo klauzole legislative, rregullatore apo administrative.

“E drejtë e veçantë ose ekskluzive” do të thotë një e drejtë që e kufizon të drejtën për kryerjen e veprimtarisë në fjalë, duke ua dhënë atë vetëm një a më shumë shoqërive tregtare. Kjo e drejtë duhet ta vendosë entin në një pozicion monopoli ose oligopoli, në mënyrë që të mund t’ua kalojë kostot klientëve, meqenëse ata nuk do të kenë alternativë tjetër. Përveç kësaj, e drejta ekskluzive ose e veçantë duhet, gjithashtu të ketë një ndikim të madh te sipërmarrjet e tjera që duan të kryejnë të njëjtën veprimtari dhe ta bëjë të vështirë, si nga ana ligjore, ashtu dhe nga ana praktike, hyrjen e shoqërive tregtare të tjera në të njëjtin sektor, në të njëjtën zonë gjeografike.

Nëse një e drejtë e veçantë ose specifike mund të merrret nga të gjitha entet që e kërkojnë atë, këto shoqëri tregtare nuk u nënshtrohen këtyre rregullave, pasi ato operojnë në një treg konkurrues.

c) Entet private, që kryejnë veprimtari në sektorët e shërbimit ujqor, energjetik, transportit dhe atij postar, pas fitimit të një kontrate prokurimi, nuk u nënshtrohen këtyre rregullave, edhe në rastet kur ato përfundojnë në një pozicion monopolistik ose oligopolistik.”.

2. Kontratat sektoriale

a) “Kontratat sektoriale” janë kontrata publike, të lidhura nga autoritetet kontraktore për qëllime të kryerjes së secilës prej veprimtarive të mbuluara nga sektorët e shërbimit ujqor, energjetik, transportit dhe atij postar. Veprimtaritë e mbuluara nga rregullat për prokurimin e kontratave sektoriale janë vetëm ato veprimtari që janë përcaktuar shprehimisht në LPP dhe që i ofrojnë një shërbim publikut.

b) Autoritetet kontraktore që prokurojnë mallrat, shërbimet dhe punët për kontrata sektoriale zbatojnë këto rregulla. Këto rregulla do të zbatohen edhe për rastet kur një autoritet kontraktor organizon një konkurs projektimi për të operuar në këta sektorë. Si rregull, autoriteti kontraktor do të zbatojë rregullat për prokurimin e kontratave sektoriale për të gjitha blerjet, për sa kohë që objekti që do të prokurohet do të përdoret vetëm për veprimtaritë e kontratave sektoriale. Autoriteti kontraktor nuk mund të përdorë rregullat e këtij kreu për të prokuruar mallra, shërbime ose punë të cilat nuk janë planifikuar për t’u përdorur në sektorët e shërbimit ujqor, energjetik, transportit dhe atij postar.

3. Sektorët e shërbimit ujqor, energjetik, transportit dhe atij postar

3.1 Sektori i shërbimit energjetik

Sektori i shërbimit energjetik mbulon ofrimin ose përdorimin e rrjeteve fikse që kanë për qëllim t’i ofrojnë publikut shërbime në lidhje me prodhimin, transportin ose shpërndarjen e energjisë elektrike, të gazit apo të nxehtësisë, ose furnizimin me energji elektrike, gaz apo nxehtësi ndaj këtyre rrjeteve. Përbën përjashtim dhënia e kontratave sektoriale për furnizimin me energji elektrike, nxehtësi ose karburante për përdorim për prodhimin e energjisë. Kontrata të tilla nuk ka nevojë të prokurohen. Entet private mbulohen nga rregullat vetëm nëse ato operojnë në sektorin e energjisë pas dhënies së një të drejte të veçantë ose ekskluzive.

3.2 Shfrytëzimi i naftës, gazit ose qymyrit

Veprimtaritë që përfshijnë shfrytëzimin e një zone gjeografike për qëllime eksplorimi, me mundësinë për të nxjerrë naftë, gaz, qymyr apo karburante të tjera të ngurta, u nënshtrohen rregullave për kontratat sektoriale. Nëse entet private operojnë në atë zonë, ato përfshihen vetëm nëse atyre u është dhënë një e drejtë e veçantë ose ekskluzive.

3.3 Portet dhe aeroportet

Veprimtaritë që përfshijnë shfrytëzimin e zonave gjeografike me qëllim ofrimin e aeroporteve dhe të porteve detare ose tokësore, ose të strukturave të tjera të terminaleve për transportuesit ajrorë, detarë apo të ujërave tokësore, u nënshtrohen rregullave të sektorëve të shërbimeve publike.

Nëse entet private janë pronarë dhe operojnë në këtë zonë, ato përfshihen vetëm nëse u është dhënë një e drejtë e veçantë ose ekskluzive.

3.4 Uji i pijshëm

Veprimtaritë ujore u përkasin sektorëve të shërbimeve publike, nëse ato kanë të bëjnë me ofrimin ose përdorimin e rrjeteve publike fikse të prodhimit, të transportit a të shpërndarjes së ujit të pijshëm apo furnizimin me ujë të pijshëm ndaj rrjeteve. Kontratat e akorduara për punime inxhinierike, hidraulike, vaditje dhe drenazhim u nënshtrohen gjithashtu rregullave të kontratave sektoriale, nëse volumi i ujit të përdorur për furnizim me ujë të pijshëm është më tepër se 20% e volumit të përgjithshëm të ujit. Ndjekja e veprimtarive për largimin ose trajtimin e ujërave të zeza konsiderohet, gjithashtu, pjesë e sektorit ujqor, nëse veprimtaria kryhet nga një autoritet kontraktor, i cili operon gjithashtu në sektorin e ujit të pijshëm. Kontratat për furnizimin me ujë të pijshëm janë të përjashtuara dhe mund të prokurohen pa konkurrim.

3.5 Transporti publik – transporti me autobus

Ofrimi dhe operimi i rrjeteve të synuara për ofrimin e një shërbimi ndaj publikut në fushën e transportit me hekurudhë, sistemeve automatike, tramvajeve, autobusëve elektrikë, shërbimeve me autobus ose teleferik u nënshtrohen rregullave të shërbimeve publike. Një rrjet konsiderohet se

ekziston atëherë kur shërbimi ofrohet sipas të njëjtave kushte të vendosura nga një autoritet kompetent.

Kushtet përfshijnë itineraret që do të shërbehen, kapacitetet që do të bëhen të disponueshme ose shpeshhtësinë e shërbimit.

Sektori i transportit publik nuk mbulon transportimin e mallrave, meqenëse këto transporte nuk u nënshtrohen kushteve të funksionimit të parashtruara nga një autoritet kompetent. Autoriteti kontraktor që operon në transportin e mallrave, mbulohet në të kundërt nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik. Enteve private që operojnë në transportin e mallrave nuk u duhet të ndjekin ndonjë prej rregullave të prokurimit publik.

Këto rregulla nuk janë të zbatueshme nëse shërbime të rregullta transporti mund të ofrohen prej agjencive të tjera të transportit në të njëjtën zonë gjeografike dhe në të njëjtat kushte. Sektori i transportit nuk përfshin edhe transportin publik që nuk është i mbuluar nga disa kushte funksionimi të caktuara, si transporti me autobusë privatë nga njëri qytet në tjetrin apo transportet private ndërkombëtare me autobus.

3.6 Shërbimet postare

“Shërbime postare” quhen ato shërbime që kanë të bëjnë me zhdoganimin, klasifikimin, përcaktimin e itinerareve dhe dorëzimin e artikujve postarë. Kur autoriteti kontraktor ofron shërbime postare, edhe shërbime të tjera që kanë lidhje me to janë të mbuluara nga rregullat për prokurimin e kontratave sektoriale. Nëse një enti privat i nevojitet një e drejtë e veçantë ose ekskluzive për të operuar një shërbim postar, ai është gjithashtu i mbuluar nga këto rregulla.

4. Prokurimi që përfshin disa veprimtari të ndryshme

Një autoritet kontraktor mund t’u nënshtrohet si rregullave të përgjithshme të prokurimit publik, ashtu edhe rregullave të prokurimit të kontratave sektoriale të këtij kreu. Kjo do të thotë që një autoritet kontraktor, në disa raste, duhet t’u përmbahet klauzolave të rregullave të përgjithshme dhe më pas të zbatojë klauzolat e këtij kreu, kur prokuron për një lloj tjetër veprimtarie. Në këto raste do të përdoren rregullat për veprimtarinë kryesore, për të cilën kontrata është e paracaktuar.

Në disa raste, autoriteti kontraktor operon në sektorët e shërbimit ujqor, energjetik, transportit e atij postar dhe kryen veprimtari që nuk mbulohen aspak nga rregullat e prokurimit të kontratave sektoriale.

5. Kontratat e lidhura për qëllime të rishitjes apo dhënies me qira palëve të treta

Kontratat sektoriale të lidhura nga autoriteti kontraktor për qëllime të rishitjes apo dhënies me qira palëve të treta nuk mbulohen nga rregullat, nëse nuk ekziston një e drejtë e veçantë ose ekskluzive në lidhje me objektin e kontratës.

Kushti për përjashtim është që autoriteti kontraktor në asnjë mënyrë nuk i përpunon produktet, por vetëm i blen dhe i shet ato pa pasur ndonjë të drejtë ekskluzive.

6. Sipërmarrjet e lidhura

a) Sipërmarrjet e lidhura përfshijnë mallrat, shërbimet dhe punimet. Përjashtimi ka të bëjë në faktin që blerjet nga të ashtuquajturat sipërmarrje të lidhura (në parim, shoqëria tregtare nënë, motër dhe nëndegë të shoqërisë tregtare) apo brenda një bashkimi operatorësh, nuk ka nevojë të prokurohen sipas rregullave të këtij kreu. Vetëm autoriteti kontraktor që kryen veprimtari në sektorët e shërbimit ujqor, energjetik, transportit dhe atij postar mund ta përdorë përjashtimin.

b) Sipërmarrjet e lidhura janë subjekt i xhiros mesatare të shitjeve të punimeve, furnizimeve ose kontratave të shërbimit të shoqërisë tregtare gjatë tri viteve të mëparshme. Të paktën 80 për qind e xhiros duhet të vijë nga furnizimi i të njëjtave mallra, shërbime ose punime që do të prokurohen, shoqërive tregtare me të cilat ajo është e lidhur. Autoriteti tjetër kontraktor mund të shesë deri në 20 për qind të produkteve, shërbimeve dhe punimeve në fjalë në tregun e hapur. Kufizimi është hartuar për t’ua parandaluar shoqërive tregtare konkurrimin me shoqëri tregtare të tjera dhe për të shijuar përfitimet e të operuarit vetëm e pa konkurrencë për furnizimin e bizneseve me pozicion monopolistik ose oligopolistik. Nëse më tepër se një shoqëri tregtare e lidhur me autoritetin kontraktor ofron punime ose shërbime të njëjta apo të ngjashme, është e domosdoshme të llogaritet duke iu referuar xhiros totale të të gjithave shoqërive tregtare të lidhura. Nëse xhiroja e krijuar nga shoqëritë tregtare të jashtme i kalon 20%, përjashtimi nuk është i zbatueshëm.

c) Shoqëritë tregtare të reja nuk kanë xhiro të tri viteve të fundit për ta paraqitur. Këto shoqëri tregtare në vend të kësaj mund të përmbushin kërkesat që, të paktën, 80 për qind të shitjeve t'i kenë bërë te shoqëritë tregtare të lidhura. Kjo do ta bënte më të lehtë përdorimin e këtij përjashtimi për grupet e reja të biznesit, si edhe për degët e sapoformuara.

ç) Në mënyrë që të lehtësojnë bashkëpunimin në projektet madhore, autoritetet kontraktore që operojnë në sektorët e shërbimit ujqor, energjetik, transportit dhe atij postar mund të formojnë të ashtuquajturat bashkime operatorësh. Bashkimet e operatorëve mund të blejnë mallra, shërbime ose punime nga njëri prej autoriteteve kontraktore që janë partnerë, pa e shpallur kontratën për konkurrim. Kushti është që autoritetet kontraktore të kenë formuar bashkimin e operatorëve ekskluzivisht për të kryer një veprimtari në sektorët e shërbimit ujqor, energjetik, transportit dhe atij postar.

7. Sistemet e kualifikimit

a) Autoritetet kontraktore në sektorët e shërbimit ujqor, energjetik, transportit dhe atij postar mund të krijojnë dhe të zbatojnë një skemë të veçantë për parakualifikimin e furnitorëve, një sistem kualifikimi. Qëllimi i një sistemi kualifikimi është të kursejë kohë kur një autoritet kontraktor blen rregullisht disa mallra, shërbime dhe punime të caktuara.

Sistemi zëvendëson fazën e parë të një procedure me përzgjedhje ose të negociuar dhe duhet të përmbajë kriteret përzgjedhjeje që zakonisht u vihen furnitorëve në fazën e parë të prokurimit. Kriteret e përzgjedhjes duhet t'u bëhen të disponueshme të gjithë furnitorëve të interesuar.

b) Të gjithë operatorët ekonomikë, që kërkojnë të përfaqësohen dhe që përmbushin kriteret e përzgjedhjes, do të përfshihen në sistem. Aplikimet do t'i dorëzohen autoritetit kontraktor, i cili duhet ta shqyrtojë aplikimin brenda gjashtë muajve.

Një operator ekonomik, të cilit i janë refuzuar aplikimet, do të njoftohet për arsyet brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit.

Një operator ekonomik që është pranuar në sistem mund të përjashtohet vetëm për arsye të shprehura në rregullat e sistemit.

c) Atëherë kur duhet të prokurohen mallra ose shërbime, autoriteti kontraktor mund t'i drejtohet drejtpërsëdrejti operatorit ekonomik në listë, pa pasur nevojë të shpallë blerje me konkurrim.

Autoritetit kontraktor nuk i duhet të pyesë të gjithë operatorët ekonomikë të përfshirë në listë, por i duhet që gjithmonë t'i pyesë ata operatorë ekonomikë që kanë aftësinë për të përmbushur kontratën specifike.

8. Procedura me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës

Një autoritet kontraktor mund të akordojë kontrata sektoriale nëpërmjet një procedure me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës në rastet kur:

- nuk është dorëzuar asnjë ofertë ose nuk ka asnjë ofertë apo aplikim të përshtatshëm në përgjigje të procedurës së hapur, të kufizuar ose të negociuar me shpallje paraprake të njoftimit, me kusht që të mos ketë ndryshime thelbësore të kushteve fillestare të kontratës.

Nëse nuk dorëzohen oferta si rezultat i gabimeve në dokumentet standarde të tenderit dhe/ose si rezultat i një veprimi të autoritetit kontraktor, dhe/ose nëse është e nevojshme të bëhen ndryshime thelbësore në kushtet e kontratës, atëherë duhet të organizohet një procedurë e re e hapur ose e kufizuar. Autoriteti kontraktor duhet të ndërmarrë masat e nevojshme në mënyrë që të korrigjojë veprimet që kanë shkaktuar dështimin e procedurës.

- Për arsye teknike ose artistike apo për arsye që kanë lidhje me të drejtat ekskluzive të pronësisë intelektuale, kontrata mund të ekzekutohet vetëm nga një operator ekonomik i veçantë.

Ky kusht përmbushet vetëm në rastin e prokurimeve për të cilat nuk ka konkurrim në treg dhe kur ky i fundit certifikohet nga autoriteti kompetent. Për sa i përket arsyeve teknike, duhet të jetë vetë rezultati, që vetëm një operator është në gjendje të ofrojë, e jo procesi. Përjashtimi është i zbatueshëm këtu vetëm në rast se ekziston një e drejtë ekskluzive për shkak të një patente apo diçkaje të ngjashme.

Situata është e njëjtë edhe në rastin e përjashtimit për arsye artistike. Nëse disa artistë mund ta kryejnë kontratën, për këtë duhet organizuar një konkurrim.

- Për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor i parashikuar në nenin 43 të ligjit, për njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negociim, me publikim, nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor.

Për të argumentuar përdorimin e një procedure të negociuar pa publikim për shkak të një emergjence ekstreme, duhen përmbushur katër kushtet e mëposhtme:

- duhet të ekzistojë një ngjarje objektivisht e paparashikueshme, jo vetëm e paparashikueshme prej autoritetit kontraktor;

- ngjarja nuk duhet t'i atribuohet autoritetit kontraktor;

- ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshme të komunitetit në gjerësi;

- duhet të jetë e pamundur të ndiqet procedura standarde (e hapur, e kufizuar ose e negociuar me shpallje të njoftimit).

Autoriteti kontraktor duhet të provojë, justifikojë dhe dokumentojë se nevoja ekstreme ose situata emergjente nuk janë pasojë e veprimit apo mosveprimit të tij. Neglizhenca ose vonesat, në fillimin e procedurave normale të prokurimit, nuk do të merren parasysh si shkaqe që mund të justifikojnë zbatimin e kësaj procedure. Kjo procedurë nuk do të adoptohet për të përligjur përfundimin e kontratave afatgjata, por vetëm për të përballuar situatën emergjente. Në rast emergjence, autoriteti kontraktor do të marrë njëkohësisht të gjitha masat për kryerjen e procedurave normale të prokurimit.

- Një kontratë shpallet fituese, bazuar në marrëveshjen kuadër, me kusht që të respektohen kërkesat e nenit 58/9 të ligjit.

Një autoritet kontraktor duhet të përdorë procedurën e hapur, të kufizuar ose me negociim me shpallje të njoftimit të kontratës kur prokuron një marrëveshje kuadër në sektorët e shërbimit publik. Nëse marrëveshja kuadër është prokuruar në bazë të rregullave të ligjit, autoritetit kontraktor nuk i duhet të publikojë njoftim të kontratës për kontratat e përgatitura sipas kësaj marrëveshjeje kuadër.

- Kemi të bëjmë me furnizime shtesë nga furnitori fillestar, të konsideruara si zëvendësim i pjesshëm i furnizimeve normale apo i instalimeve ekzistuese ose si zgjerim i furnizimeve aktuale, ku një ndryshim i furnitorit do ta detyronte autoritetin kontraktor të blinte materiale që do të kishin specifikime të ndryshme teknike, të cilat do të rezultonin në mospërputhshmëri ose në vështirësi të mëdha teknike gjatë shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes. Në këtë rast, kontrata shtesë do të nënshkruhet brenda një kufiri kohor prej 3 (tre) muajsh, nga përfundimi i kontratës fillestare, dhe nuk duhet të kalojë 20% të vlerës së përgjithshme të kontratës fillestare.

Ky përjashtim nuk mund të përdoret si justifikim për mosshpalljen e kontratës për konkurrim. Autoriteti kontraktor duhet të provojë, arsyetojë dhe dokumentojë se një ndryshim i furnitorit do të rezultonte në mospërputhshmëri ose në vështirësi të mëdha teknike. Neglizhenca ose vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk do të vlerësohen si shkaqe që justifikojnë zbatimin e kësaj procedure.

- Kemi të bëjmë me furnizime të kuotuar dhe të blera në tregun e mallrave të përdorimit të gjerë.

Ky përjashtim bëhet sepse operatori ekonomik e ka dhënë tashmë çmimin më të mirë. Për këtë arsye nuk është i nevojshëm një tjetër konkurrim.

- Kemi të bëjmë me blerje me leverdi, ku është e mundur të prokurohen furnizime duke shfrytëzuar një mundësi veçanërisht të mirë, të disponueshme vetëm për një periudhë të shkurtër kohe, me një çmim shumë më të ulët se çmimet normale të tregut.

Çmimet e disponueshme duhet të jenë shumë më të ulëta sesa është normalisht e mundur të negociohet me një operator ekonomik normal.

- Kemi të bëjmë me blerje të furnizimeve me kushte veçanërisht favorizuese, qoftë nga një furnitor që mbyll përfundimisht veprimtarinë e biznesit të tij, qoftë nga përfituesit apo likuiduesit e një falimentimi, nga një marrëveshje me kreditorët ose nga një procedurë e ngjashme, në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare në fuqi.

- Kemi të bëjmë me punime apo shërbime shtesë, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në kontratën fillestare, por që, për shkak të rrethanave të paparashikuara, bëhen të domosdoshme për ecurinë e punimeve apo shërbimeve të përshkruara në kontratë, me kusht që kontrata t'i akordohet operatorit ekonomik që është duke i kryer këto punime a shërbime; për sa kohë që vlera totale e kontratave të akorduara për punimet dhe shërbimet shtesë nuk e kalon 20% të vlerës së përgjithshme të kontratës fillestare, kur këto punime ose shërbime:

i) nuk mund të ndahen teknikisht apo ekonomikisht nga kontrata fillestare, pa shkaktuar probleme të mëdha për autoritetin kontraktor;

ii) megjithëse mund të ndahen nga kryerja e kontratës fillestare, ato janë tepër të domosdoshme për përfundimin e saj.

- Bëhen punime të reja, që kanë të bëjnë me përsëritjen e punimeve të ngjashme që i besohen operatorit ekonomik, me të cilin autoriteti kontraktor ka lidhur kontratën fillestare, me kusht që këto punime apo shërbime të jenë në përputhje me një projekt bazë për të cilin është lidhur kontrata fillestare, mbi bazën e një procedure prokurimi. Sapo projekti i parë është gati për tender, përdorimi i mundshëm i kësaj procedure do të bëhet i ditur në njoftimin e kontratës për kontratën fillestare, dhe vlera e përafërt totale e shpenzimeve të punimeve do të merret parasysht nga autoriteti kontraktor. Kjo procedurë mund të përdoret vetëm gjatë 3 (tri) viteve që pasojnë përfundimin e kontratës origjinale. Në asnjë rast kontrata shtesë nuk duhet të kalojë 20% të vlerës së përgjithshme të kontratës fillestare.

Kjo procedurë mund të përdoret vetëm në rast se është përmendur dhe përshkruar paraprakisht në njoftimin e kontratës bazë të prokurimit. Ajo është një lloj mundësie dhe autoriteti kontraktor mund të zgjedhë nëse do ta përdorë atë apo jo. Kushtet, si çmimi, duhet të përcaktohen në dokumentet standarde të tenderit. Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës së parë, AK-ja duhet ta bëjë llogaritjen me vlerën e plotë të secilit prej këtyre punimeve shtesë.

KREU IV/B MARRËVESHJA KUADËR

1. Përkufizim

Një marrëveshje kuadër mund të lidhet ndërmjet disa autoriteteve kontraktore dhe disa operatorëve ekonomikë. Një marrëveshje kuadër mund të lidhet ndërmjet disa autoriteteve kontraktore dhe një operatori ekonomik ose ndërmjet një autoriteti kontraktor dhe disa operatorëve ekonomikë. Në respektim të parimit të transparencës, autoritetet kontraktore, që janë palë në marrëveshje dhe që për këtë arsye u lejohet të bëjnë kontratëporosi, duhet të listohen në njoftimet, në dokumentet e kontratës dhe në marrëveshjet kuadër. Të gjithë operatorët ekonomikë, që janë pjesë e marrëveshjes, duhet të listohen në marrëveshje.

Nuk është e lejueshme të përdorin një marrëveshje kuadër autoritetet kontraktore të cilat nuk janë të listuara.

Gjithashtu, nuk është e lejueshme të pranohen operatorë ekonomikë të tjerë në marrëveshje, pas përfundimit të procesit të prokurimit.

Një marrëveshje kuadër, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, konsiderohet një kontratë e përfunduar. Kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër të tillë janë pjesë e një kontrate tashmë të përfunduar. Për këtë arsye, nuk është e mundur që Komisioni i Prokurimit Publik të marrë masa të përkohshme, sipas ligjit për prokurimin publik, ndaj një marrëveshjeje kuadër të përfunduar.

Një marrëveshje kuadër, ku nuk përcaktohen të gjitha kushtet, nuk konsiderohet një kontratë. Në këtë rast, secila kontratë e bazuar në marrëveshjen kuadër konsiderohet një kontratë e re, që do të thotë se Komisioni i Prokurimit Publik mund të veprojë në lidhje me shqyrtimin e ankesave, sipas ligjit për prokurimin publik, ndaj këtyre kontratave, përpara se ato të përfundojnë.

Një marrëveshje kuadër është ligjërish e detyrueshme për të dyja palët. Autoritetet kontraktore nuk janë të detyruara të prokurojnë një sasi të caktuar mallrash, shërbimesh ose punësh të përfshira në marrëveshje. Por, në rast se ato prokurojnë mallra, shërbime ose punë që janë të përfshira, ato duhet të përdorin marrëveshjen. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të dorëzojnë

objektin e kontratës sipas cilësisë dhe çmimit të ofertuar, në kohën e kërkuar prej autoriteteve kontraktore. Gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër autoritetet kontraktore nuk lejohen të blejnë nga asnjë operator ekonomik tjetër të njëjtat mallra, shërbime ose punë të mbuluara nga një marrëveshje kuadër, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes.

2. Qëllimi

Ndryshimi ndërmjet një marrëveshjeje kuadër dhe kontratave të tjera që lidhen sipas procedurave të prokurimit, të parashikuara në ligjin për prokurimin publik, është se sasia aktuale e mallrave, shërbimeve ose e punëve që do të prokurohen nuk është e përcaktuar në një marrëveshje kuadër. Për këtë arsye, këto lloj marrëveshjesh mund të përdoren kur autoritetet kontraktore e dinë me siguri objektin që do të prokurojnë, por nuk dinë sasinë që do të prokurojnë. Nëse një marrëveshje kuadër prokurohet sipas rregullave për kufijtë limit, për një periudhë katërvjeçare, autoritetet kontraktore, të cilat janë pjesë e marrëveshjes, mund të blejnë një sasi të pakufizuar përgjatë kësaj periudhe.

Autoritetet kontraktore mund të blejnë vetëm për të plotësuar nevojat e tyre dhe jo për nevoja të autoriteteve kontraktore që nuk janë pjesë në marrëveshjen kuadër.

3. Prokurimi

Marrëveshja kuadër prokurohet sipas këtyre rregullave. Ajo mund të lidhet vetëm pasi autoritetet kontraktore të kenë kryer një procedurë të hapur, të kufizuar ose me negociim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. Në kontratat sektoriale, autoritetet kontraktore mund të përdorin, gjithashtu, procedurën me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.

Operatorët ekonomikë përzgjidhen duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve të nenit 55 të ligjit për prokurimin publik. Kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër janë të ndryshme, në varësi të llojit të marrëveshjes kuadër të përdorur.

Njoftimi i fituesit për një marrëveshje kuadër, duhet të publikohet.

Autoritetet kontraktore nuk duhet të publikojnë fituesin për një kontratë bazuar në marrëveshjen kuadër.

4. Kushtet

Kohëzgjatja e një marrëveshjeje kuadër nuk mund të jetë më shumë se katër vjet. Në marrëveshjen kuadër përcaktohen kushtet, në bazë të të cilave do të lidhen kontratat. Kushtet do të jenë të ndryshme, në varësi të llojit të marrëveshjes kuadër që prokurohet.

5. Marrëveshjet me një operator ekonomik dhe ku janë të përcaktuara të gjitha kushtet

Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura vetëm me një operator ekonomik duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Në kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër nuk mund të bëhen ndryshime thelbësore të kushteve, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes kuadër. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë në mënyrë thelbësore, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re. Një operatori ekonomik mund t'i kërkohej të përgatisë ofertën e tij, vetëm në lidhje me ato kushte që nuk kanë ndonjë ndikim thelbësor mbi kushtet e rena dakord paraprakisht në marrëveshjen kuadër.

6. Marrëveshjet me disa operatorë ekonomikë dhe ku janë të përcaktuara të gjitha kushtet

Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër, ku janë të përcaktuara të gjitha kushtet, të lidhura me disa operatorë ekonomikë duhet të akordohen brenda kufijve të kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Meqenëse këto marrëveshje kuadër vlerësohen si kontrata, nuk lejohet të bëhen ndryshime thelbësore të kushteve të tyre, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e kontratës. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë në mënyrë thelbësore, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re.

Marrëveshjet kuadër me disa operatorë ekonomikë duhet të lidhen me të paktën tre operatorë ekonomikë, nëse të tre operatorët ekonomikë i kanë përmbushur të gjitha kriteret e përzgjedhjes dhe të shpalljes së kontratës fituese. Në rast të kundërt, autoritetet kontraktore mund të lidhin marrëveshje kuadër me ata operatorë ekonomikë që i kanë përmbushur të gjitha kriteret, edhe sikur të jenë vetëm dy.

7. Marrëveshjet me disa operatorë ekonomikë dhe ku nuk janë të përcaktuara të gjitha kushtet

Marrëveshjet kuadër ku nuk janë të përcaktuara të gjitha kushtet nuk konsiderohen kontrata, sipas ligjit për prokurimin publik. Përkundrazi, kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër përbëjnë kontratat e prokurimit. Kjo do të thotë që për çdo kontratë të bazuar në marrëveshjen kuadër autoriteti kontraktor duhet të bëjë një konkurrim të ri ndërmjet atyre operatorëve ekonomikë, që janë pjesë e marrëveshjes. Nuk është e nevojshme të ftohen të gjithë operatorët ekonomikë të marrin pjesë në një konkurrim të ri, por autoriteti kontraktor duhet të ftojë të gjithë ata operatorë ekonomikë në marrëveshje, që zotërojnë kapacitetet për të përmbushur kontratën.

Në njoftimin dërguar operatorëve ekonomikë, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë kriteret e përcaktimit të ofertës fituese për kontratën e bazuar në marrëveshjen kuadër. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese mund të jenë të njëjta si ato të marrëveshjes kuadër. Autoriteti kontraktor, gjithashtu, mund të përdorë kritere të tjera, vetëm në rast se ato kritere janë të përcaktuara në dokumentet e marrëveshjes kuadër fillestare. Këto kritere mund të jenë çmimet për volume të caktuara, informacion për konsulencat për një shërbim intelektual, koha e nevojshme për dorëzim ose orët e nevojshme për kryerjen e punimeve specifike.

Kjo lloj marrëveshjeje kuadër nuk është e zbatueshme në rastet e kontratave sektoriale.”.

5. Në pikën 4 të kreu VI “Zhvillimi i procedurës së kërkesës për propozim, prokurimi me vlera të vogla, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit”, bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “b” “Konkursi i projektimit”, shfuqizohet.

b) Në shkronjën “d”, fjalët “... ose që janë të përfshirë në më shumë se një projekt...”, shfuqizohen.

6. Në kreu VII “Kushtet e përgjithshme për zbatim”, bëhen këto ndryshime:

a) Fjalja e dytë e shkronjës “b” të pikës 1, shfuqizohet.

b) Dy paragrafët e fundit të shkronjës “b” të pikës 3, shfuqizohen.

7. Në shkronjat “b” e “d” të pikës 1 të kreu IX “Shqyrtimi i ankesave”, dhe në shkronjën “a” të pikës 2 të këtij kreu, fjalët “... brenda 5 ditë pune” zëvendësohen me “...brenda 7 ditëve kalendarike...”.

8. Kreu X “Sanksionet administrative dhe masat disiplinore”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“KREU X

SANKSIONET ADMINISTRATIVE DHE MASAT DISIPLINORE

1. Mosrespektimi i rregullave të prokurimit, në përputhje me dispozitat e LPP-së, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, të përcaktuar përkatësisht:

a) Autoriteti kontraktor, që nuk përmbush detyrimin e përcaktuar në pikën 2 të nenit 12 të LPP-së, gjobitet nga 50 000 deri në 100 000 lekë;

b) Autoriteti kontraktor, që nuk përmbush detyrimin e krijimit të një regjistri, të përcaktuar në pikën 3 të nenit 12 të LPP-së, gjobitet nga 30 000 deri në 50 000 lekë;

c) Autoriteti kontraktor, që nuk përmbush detyrimin e dorëzimit të raporteve të veprimtarisë së tij të prokurimit, sipas afatit të përcaktuar në pikën 1 të nenit 12 të LPP-së, gjobitet nga 15 000 deri 30 000 lekë;

ç) Autoriteti kontraktor, që nuk përmbush detyrimin për formën e komunikimit, për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit, të përcaktuar në nenet 21, pika 3, e 22 të LPP-së, gjobitet nga 50 000 deri në 100 000 lekë;

d) Autoriteti kontraktor, që nuk përmbush detyrimin e parashikuar në nenin 23 të LPP-së, gjobitet nga 30 000 deri në 50 000 lekë;

dh) Autoriteti kontraktor, që nuk përmbush detyrimin e përcaktuar në nenin 25 të LPP-së, gjobitet nga 50 000 deri në 80 000 lekë;

e) Autoriteti kontraktor, që nuk përmbush detyrimin e përcaktuar në nenin 38 të LPP-së, gjobitet nga 50 000 deri në 100 000 lekë;

ë) Autoriteti kontraktor, që nuk përmbush detyrimin e përcaktuar në nenin 42 të LPP-së, gjobitet nga 50 000 deri në 100 000 lekë;

f) Personat, që përpiqen të ndikojnë në vendimmarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik, në kundërshtim me nenin 19/7 të LPP-së, gjobiten nga 50 000 deri 100 000 lekë.

2. Refuzimi i nëpunësit civil, i funksionarit ose i autoritetit publik për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik, Agjencinë e Prokurimit Publik dhe Avokatit e Prokurimeve përbën shkak që këto institucione t'i kërkojnë Agjencisë së Prokurimeve Publike propozimin e masave disiplinore tek autoritetet kontraktore përgjegjëse.

3. Në çdo rast tjetër të shkeljes së dispozitave të LPP-së, që nuk është përmendur më sipër, kërkohet dhënia e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës. Në dhënien e masës administrative apo disiplinore, duhet të mbahen parasysh rrethanat, pasojat dhe roli i zyrtarit në shkelje dhe, në çdo rast, zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative. Sanksionet administrative dhe masat disiplinore nuk përjashtojnë përgjegjësinë penale të personit përgjegjës për shkeljet.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.399, datë 26.5.2010

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË ADMINISTRATËS SË
AKADEMISË SË SHKENCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Numri i punonjësve të administratës së Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë të jetë, gjithsej, 29 veta.


3. Vendimi nr.636, datë 14.5.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së administratës së Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ORGANIGRAMA E AKADEMISE SE SHKENCAVE E SHQIPERISE



STRUKTURA DHE ORGANIKA E ADMINISTRATËS SË AKADEMISË SË
SHKENCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

	Emërtimi i funksionit	Nr. i punonjësve
1	Kryesia	3
	- Kryetar	1
	- Zëvendëskryetar	1
	- Sekretar shkencor	1
2	Dega e personelit dhe sekretaria e kryesisë	1
	- Kryetar dege, sekretare	1
3	Seksionet shkencore	6
	- Seksioni i shkencave shoqërore dhe albanologjike	3
	- Kryetar seksioni (akademik/akademik i asocuar)	1
	- Sekretar shkencor i seksionit (profesor)	1
	- Asistent i seksionit (arsim i lartë)	1
	- Seksioni i shkencave natyrore dhe teknike	3
	- Kryetar seksioni (akademik/akademik i asocuar)	1
	- Sekretar shkencor i seksionit (profesor)	1
	- Asistent i seksionit (arsimi i lartë)	1
4	Njësia e projekteve të kërkimit dhe zhvillimit, teknologjive dhe inovacioneve	1
	Punonjës shkencor për projektet (profesor)	1
5	Dega e marrëdhënieve me jashtë dhe me publikun	1
	Kryetar dege	1
6	Dega e botimeve shkencore	4
	- Botime periodike shkencore në gjuhë të huaj	2
	- Studia Albanica (revistë) (redaktore shkencore)	1
	- Albania Journal Natyral and Technical Sciences (revistë) (redaktore shkencore)	1
	Botime të veprave të rëndësishme shkencore (monografi, traktate, studime)	2
	- Redaktor	1
	- Laborant-editor	1
7	Dega e financës dhe administratës	8
	- Kryetar dege	1
	- Specialist buxheti	1
	- Laborant-magaznier	1
	- Protokoll-arkivist	1
	- Teknik mirëmbajtës	1
	- Roje, korrier	1
	- Shofer	1
	- Pastruese	1
8	Biblioteka shkencore	4
	- Përgjegjës (me gradë shkencore)	1
	- Bibliografe	1
	- Bibliotekare	1
	- Pastruese	1
9	ICT-Specialist	1
	- Specialist	1
	Gjithsej numri i punonjësve	29

VENDIM
Nr.400, datë 26.5.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “FLETI 1” DHE “FLETI 2”, DHE MIRATIMIN
E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET
SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve “Fleti 1” dhe “Fleti 2”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 4 % të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Adnain”, sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Fleti 1” dhe “Fleti 2”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.401, datë 26.5.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “KASKADA E HIDROCENTRALEVE NË LUMIN
SETA”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE
KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3 e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Kaskada e hidrocentraleve në lumin Seta”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 % të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Eurocostruzioni”, s.p.a.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Kaskada e hidrocentraleve në lumin Seta”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.402, datë 26.5.2010

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “TRUEN”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Truen”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 4% të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “2A Power” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Truen”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.403, datë 26.5.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “OPAR 1”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Opar 1”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 4 % të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “IT-AL Service” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Opar 1”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.405, datë 26.5.2010

**PËR KALIMIN NË PËRGGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR DREJTORINË E
PËRGGJITHSHME TË RRUGËVE, TË NJË SIPËRFAQEJE NGA TRUALLI FUNKSIONAL I
PRONËS NR.231 “SHTËPIA E PUSHIMIT TË USHTARAKËVE”, NË PLEPA, DURRËS,
DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME, SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, shkronja “b” dhe 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të sipërfaqes 1 341,32 (një mijë e treqind e dyzet e një presje tridhjetë e dy) m², nga trualli funksional i pronës nr.231 “Shtëpia e pushimit të ushtarakëve”, në

Plepa, Durrës, e cila ndodhet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas genplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi, për ta përdorur për nevoja urbanistike (rrugë publike).

2. Në listën e pronave që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të hiqet sipërfaqja 1 341,32 (një mijë e treqind e dyzet e një presje tridhjetë e dy) m² nga trualli funksional i pronës nr.231 “Shtëpia e pushimit të ushtarakëve”, në Plepa, Durrës.

3. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit e Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ndalohen ta ndryshojnë destinacionin e sipërfaqes së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojnë atë ose ta japin në përdorim të tretëve.

4. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit e Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, para fillimit të punimeve, detyrohen të marrin përsipër ndërtimin e portave hyrëse, ndërtimin e murit rrethues dhe kullave të vrojtimit në kufijtë e rinj të pronës, si dhe spostimin e rrjeteve inxhinierike, që preken gjatë punimeve, duke rehabilituar infrastrukturën që preket gjatë punimeve për funksionimin e rrugës, sipas parametrave dhe kushteve teknike.


5. Pas këtyre veprimeve paraprake dhe marrjes në dorëzim të objekteve të rehabilituara, Ministria e Mbrojtjes detyrohet të bëjë dorëzimin, sipas legjislacionit në fuqi, për kalimin në pronësi, të kësaj sipërfaqeje, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve.

6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Plan rievimi i konturit te Shtepise se Ushtarakeve
Plepa-Durres



Shpjeguese
Sip Pergjilshme e Rep =160385.07 m2
Sip me Ndertime= m2
Kufiri i Repartit

siperfaqe brenda rrethimit =1341.32 m2
eshte hedhur mbi bazen e vijes se projektit te rruges dytesore
te Drejtorise se Rrugeve

Vija e bregut eshte hedhur sipas fotografimit ajror te vitit 2007

101: Top.Dashnor Hysi
Top.Oemal Hoxha
Shefi Dep. Gjeomatikes
Major Liambi ZOTO

Shkalla 1:1000

Drejtoresh
Ing Dipl. Mh

VENDIM
Nr.406, datë 26.5.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMEVE NË SHKOLLËN E LARTË
PRIVATE “UNIVERSITETI POLIS”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në shkollën e lartë private “Universiteti Polis”, Tiranë, të programeve të studimeve të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

- a) Art dhe dizajn;
- b) Studime mjedisore.

2. Këto programe studimesh të ciklit të parë realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tri) vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në:

- a) Art dhe dizajn;
- b) Studime mjedisore.

3. Hapjen, në shkollën e lartë private “Universiteti Polis”, Tiranë, të programeve të studimeve të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

- a) Dizajn i aplikuar;
- b) Arkitekturë;
- c) Menaxhim mjedisor urban.

4. Këto programe studimesh të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë” (DND), në:

- a) Dizajn i aplikuar;
- b) Arkitekturë;
- c) Menaxhim mjedisor urban.

5. Hapjen, në shkollën e lartë private “Universiteti Polis”, Tiranë, të programeve të studimeve të ciklit të tretë “Master i nivelit të dytë” (MND), në formën e studimeve me kohë të pjesshme, në:

- a) Dizajn arkitektonik dhe parametrik;
- b) Strehim dhe zhvillim toke;
- c) Dizajn estetik strukturor;
- ç) Dizajn urban dhe pejzazhi;
- d) Zhvillim social urban dhe burime njerëzore;
- dh) Planifikim hapësinor dhe aplikime GIS.

6. Këto programe studimesh të ciklit të tretë realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të programeve të studimit lëshohet diploma “Master i nivelit të dytë” (MND), në:

- a) Dizajn arkitektonik dhe parametrik;
- b) Strehim dhe zhvillim toke;
- c) Dizajn estetik strukturor;
- ç) Dizajn urban dhe pejzazhi;
- d) Zhvillim social urban dhe burime njerëzore;
- dh) Planifikim hapësinor dhe aplikime GIS.

7. Shkolla e lartë private “Universiteti Polis”, Tiranë, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimeve, të përcaktuara në pikat 1, 3 e 5 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

8. Ky institucion duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimeve, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

9. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.407, datë 26.5.2010

PËR HAPJEN E FILIALIT TË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “KRISTAL”, NË QYTETIN E GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e filialit të shkollës së lartë private “Kristal”, në qytetin e Gjirokastrës, dhe të programeve të studimeve të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në:

- a) Infermieri;
- b) Menaxhim biznesi dhe financë;
- c) Marrëdhënie ndërkombëtare;
- ç) Drejtësi.

2. Këto programe studimesh të ciklit të parë realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 (tri) vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në:

- a) Infermieri;
- b) Menaxhim biznesi dhe financë;
- c) Marrëdhënie ndërkombëtare;
- ç) Drejtësi.

3. Filiali në Gjirokastrë i shkollës së lartë private “Kristal” ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimeve, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.408, datë 26.5.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMEVE NË SHKOLLËN E LARTË
PRIVATE “UFO UNIVERSITY”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në shkollën e lartë private “UFO University”, Tiranë, të programit të studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në “Menaxhim biznesi”.

2. Ky program studimi i ciklit të parë realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 (tri) vite akademike. Në përfundim të programit të studimit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në “Menaxhim biznesi”.

3. Hapjen, në shkollën e lartë private “UFO University”, Tiranë, të programit të studimit të ciklit të dytë, në “Shkenca juridike”, në formën e studimeve me kohë të plotë, me këto drejtime:

- a) Marrëdhënie ndërkombëtare;
- b) E drejtë publike dhe administrative;
- c) E drejtë private;
- ç) E drejtë ndërkombëtare dhe Bashkimi Europian;
- d) E drejtë penale.

4. Këto programe studimesh të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 (dy) vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë” (DND), në “Shkenca juridike”, në drejtimet:

- a) Marrëdhënie ndërkombëtare;
- b) E drejtë publike dhe administrative;
- c) E drejtë private;
- ç) E drejtë ndërkombëtare dhe Bashkimi Europian;
- d) E drejtë penale.

5. Shkolla e lartë private “UFO University”, Tiranë ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimeve, të përcaktuara në pikat 1 e 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë private “UFO University”, Tiranë, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.409, datë 26.5.2010

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË
Z. ZEF PRENDI, NË SPITALIN AMERIKAN, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 1 200 000 lekë (një milion e dyqind mijë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z. Zef Prendi, në Spitalin Amerikan, Tiranë.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit.
3. Pagesa të bëhet pas paraqitjes së faturave origjinale të institucionit shëndetësor të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.411, datë 19.5.2010

**PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE TIPIN E FORMULARIT TË LEJES SË
LEGALIZIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 28 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) lëshon lejen e legalizimit, për objektin /shtesën pa leje në ndërtime me leje, kur:
 - a) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është kryer vetëdeklarimi vullnetar brenda afatit ligjor;
 - b) objekti/shtesa pa leje në ndërtime me leje nuk ndodhet në kushtet e përjashtimit nga legalizimi, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar;
 - c) për objektin/shtesën pa leje në ndërtime me leje është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor, i parashikuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar;
 - ç) subjekti posedues ka shlyer pagesat e parashikuara në pikat 1, 2, 3 dhe 5 të vendimit nr.1180, datë 3.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit dhe mbledhjen e administrimit të adhurave të procesit të legalizimit”, të ndryshuar.

2. Procedurat e pajisjes me leje legalizimi, për objektet informale/shtesat pa leje në ndërtime me leje, të kualifikuara për legalizim, kryhen nga ALUIZNI.

3. Drejtoritë e ALUIZNI-t, pranë qarqeve, pas kualifikimit për legalizim të objekteve informale/shtesave pa leje në ndërtime me leje, veprojnë, si më poshtë vijon:

a) Publikojnë në median e shkruar dhe në faqen zyrtare të internetit, listën e poseduesve të objekteve informale/shtesave pa leje në ndërtime me leje, që kualifikohen për legalizim.

b) Hartojnë dokumentacionin teknik (genplan, planimetritë dhe fragmentin e fotografisë ajrore dixhitale).

c) Përlllogarisin detyrimet financiare të objektit informal/shtesës pa leje në ndërtime me leje, që legalizohet, dhe njoftojnë poseduesit për shlyerjen e tyre.

ç) Pranojnë nga subjekti i interesuar dokumentacionin e përcaktuar në nenet 27 e 37 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar.

d) Lidhin kontratën e kalimit të së drejtës së pronësisë së parcelës ndërtimore, nga shteti te poseduesi i objektit informal/shtesës pa leje në ndërtim me leje, në përputhje me nenin 17 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar.

dh) Përcjellin pranë Drejtorisë Qendrore të ALUIZNI-t, dokumentacionin e objektit informal/shtesës pa leje në ndërtim me leje, për kryerjen e procedurave të certifikimit.

4. Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t kontrollon dhe certifikon dokumentacionin e dërguar nga drejtoritë pranë qarqeve, plotëson procesverbalin e certifikimit dhe lëshon lejen e legalizimit, për objektin informal/shtesën pa leje në ndërtime me leje.

5. Leja e legalizimit, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim, dërgohen pranë zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nga drejtoritë e ALUIZNI-t, pranë qarqeve.

6. Për objektet informale/shtesat pa leje në ndërtime me leje, që përjashtohen nga procesi i legalizimit, drejtoritë e ALUIZNI-t, pranë qarqeve, i dërgojnë njoftim me shkrim poseduesve të tyre, si dhe organeve të njësisë të qeverisjes vendore, ku këto objekte gjenden.

7. Formulari TIP i lejes së legalizimit është sipas modelit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Vendimi nr.871, datë 27.12.2006 i Këshillit të Ministrave “Për kriteret, procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit”, shfuqizohet.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E LEGALIZIMIT URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE
DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t

LEJE LEGALIZIMI

Nr. _____ datë ___/___/200__

BAZUAR NË LIGJIN NR. 9482, DATË 03.04.2006
"PËR LEGALIZIMIN, URBANIZIMIN DHE INTEGRIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE"

PËR OBJEKTIN : _____

I JEPET: _____

Emri Atesia Mbiemri

Emri Atesia Mbiemri

Emri Atesia Mbiemri

ME ADRESË : _____

Në zonën / vendbanimin / bllok banimin / ndërtimin informal / territore të tjera,
e emërtuar me Vendimin e K.RR.T.-së/ K.RR.T.R.SH.-së. Nr. _____, datë ___/___/200__.

TË DHËNAT E OBJEKTIT: ZONA KADASTRALE _____ NR.PASURISË _____

Sipërfaqja e parcelës ndërtimore: _____ m²

Sipërfaqja e ndërtimit: _____ m²

Sipërfaqja totale e ndërtimit: për banim _____ m² / për aktivitet _____ m²

Numri i kateve: mbi tokë _____ ; nën tokë _____

Kondicione të veçanta: _____

KUFITARËT E PRONËS:

Veriu: _____

Jugu: _____

Lindja: _____

Perëndimi: _____

TË DHËNAT E MËSIPËRME JANË SIPAS GEN-PLANIT DHE PLANIMETRIVE BASHKËNGJITUR.

TITULLI I PRONËSISË MBI TOKËN I VËRTETUAR ME DOKUMENTIN:

Përgjegjësi i Sektorit të Legalizimit

Drejtori

KY DOKUMENT PLOTËSOHET NË TRE KOPJE DHE SË BASHKU ME GEN PLANIN DHE PLANIMETRITË I
OBJEKTIT. ËSHITË I VLEFSHIËM PËR REGJISTRIM NË ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME.

VENDIM
Nr.412, datë 26.5.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT” (NDËRTIM, OPERIM, TRANSFERIM), TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “BUSA” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE “STRELCA 1”, “STRELCA 2” DHE “STRELCA 3”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në kontratën e koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Busa” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Strelca 1”, “Strelca 2”, “Strelca 3”, të miratuar me vendimin nr.718, datë 14.5.2008 të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT” (NDËRTIM, OPERIM, TRANSFERIM), TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “BUSA” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE “STRELCA 1”, “STRELCA 2” DHE “STRELCA 3”, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.718, DATË 14.5.2008

Në Tiranë, sot më datë _____ 2010, palët:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, përcaktuar si “Autoriteti kontraktues” me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.128, datë 14.8.2007 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Strelca 1”, “Strelca 2” dhe “Strelca 3 dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë” dhe përfaqësuar nga titullari z.Dritan Prifti, i datëlindjes _____, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta nr.

dhe

Shoqëria “Busa” sh.p.k., me seli në rrugën “Gjergj Fishta” Tiranë, regjistruar si person juridik me vendimin nr.33476, datë 9.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; regjistruar në organin tatimor me NIPT nr.K51912007W, datë 12.7.2005, që më poshtë do të quhet “Koncesionari”, me administrator z.Mane Bulluti, i cili me prokurorë nr.1280 rep., nr.373 Kol. datë 22.2.2007, i jep të drejtën për të nënshkruar këtë marrëveshje z.Bujar Çeta, i biri i Skënderit, i datëlindjes 31.12.1966, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta Z 1427659, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, bien dakord si më poshtë:

Ta lidhë këtë marrëveshje, për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Busa” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Strelca 1”, “Strelca 2” dhe “Strelca 3”, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.718, datë 14.5.2008.

Palët bien dakord për këto shtesa dhe ndryshime të kontratës së koncesionit:

Neni 1

Në kontratën bazë të koncesionit, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.718, datë 14.5.2008:

-Kudo ku është shprehur "...hidrocentralet/eve "Strelca 1", "Strelca 2" dhe "Strelca 3", të zëvendësohen me "...hidrocentralet/eve "Strelca 1" dhe "Strelca 3".

Neni 2

Në nenin 1 "Përkufizime":

-Në pikën 1.5 fjalët "... me fuqi të instaluar të përgjithshme 8,300 kW dhe prodhim të energjisë elektrike rreth 37,653,492 kWh" zëvendësohen me fjalët "...me fuqi të instaluar të përgjithshme 4,100 kW dhe prodhim të energjisë elektrike rreth 14,700, 000 kWh".

Neni 3

Neni 3 zëvendësohet si më poshtë:

"Neni 3

Karakteristikat e hidrocentraleve "Strelca 1" dhe "Strelca 3"

Hidrocentrali "Strelca 1" do të ndërtohet në rrjedhën e përroit të Beleshit, në rrethin e Korçës, me këto karakteristika:

-Kuotat e veprave:

- Kuota e veprës së marrjes 1, 519 m;
- Kuota e godinës së centralit 1, 223 m;
- Prurja llogaritëse 0.74 m/sek;
- Fuqia e instaluar 1, 900 kW;
- Prodhimi vjetor i energjisë elektrike 6, 800, 000 kWh.

-Vepra e marrjes në rrjedhën e përroit Verba, në rrethin Korçë, do të ketë këto karakteristika:

-Kuota e veprës së marrjes 1,543 m

Uji do të dërgohet me tubacionin në liqenin e Strelca 1.

Hidrocentrali "Strelca 3" do të ndërtohet në rrjedhën e përrenjve të Beleshit dhe të Verbës, në rrethin e Korçës, me këto karakteristika:

-Kuotat e veprave:

- Kuota e veprës së marrjes 1, 218 m;
- Kuota e godinës së centralit 810 m;
- Prurja llogaritëse 0.68 m/sek;
- Fuqia e instaluar 2, 200 kW;
- Prodhimi vjetor i energjisë elektrike 7, 900, 006 kWh."

Neni 4

Në nenin 7, pika 3, shprehja "...në përputhje me propozimin për të cilin është shpallur fitues në procedurën e garës." hiqet.

Neni 5

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

Pika 2 zëvendësohet me “të paraqesë pranë autoritetit kontraktues për miratim projektin e zbatimit brenda 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.”

Në pikën 6, fjalët “...me fuqi të vendosur jo më pak se 8,300 kW” zëvendësohen me “...me fuqi të vendosur jo më pak se 4,100 kW”.

Neni 6

Neni 9 “Vlerësimi i investimeve” zëvendësohet si më poshtë:

“Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga koncesionari janë në vlerën totale prej 601 751 000 (gjashtëqind e një milion e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë) lekë, sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur, nga të cilat 133 723 000 (njëqind e tridhjetë e tre milionë e shtatëqind e njëzet e tre mijë) lekë do të investohen në makineri e pajisje.

Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve:

-pas variantit përfundimtar të projektzbatimit i cili mund të përmirësohet, por duke ruajtur të pandryshuar kuotat/termat e përcaktuara në këtë marrëveshje;

-në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës;

Vlera e ndryshuar e investimit mund të jetë më e madhe se 601 751 000 (gjashtëqind e një milion e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë) lekë, por jo më e vogël se 571 663 450 (pesëqind e shtatëdhjetë e një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë, që përfaqëson një ndryshim të investimit në vlerën 5% (pesë për qind) të investimit total të parashikuar.”.

Neni 7

Neni 10 pika 2 zëvendësohet me “2 Koncesionari merr përsipër ta vërë në punë hidrocentralin brenda 36 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje, sipas aneksit nr.1 bashkëlidhur”.

Neni 8

Në nenin 14 “Sigurimi i kontratës” në paragrafin e parë, shprehja “...një shumë prej 108 400 000 (njëqind e tetë milionë e katërqind mijë) lekë ...” zëvendësohet me “... një shumë prej 60 175 100 (gjashtëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesëmijë e njëqind) lekë...”

Neni 9

Në nenin 23 “Sanksionet”, bëhen këto ndryshime:

Në pikën 1. b, fjala “... në konkurrim...” zëvendësohet me “...në këtë marrëveshje...”.

Në pikën 2, fjalët “...në këtë kontratë...” zëvendësohen me “...në këtë marrëveshje...”

Në pikën 2.a, fjalët “... të prodhimit të energjisë elektrike prej 37,653,492 kWh/vit...” zëvendësohen me “...të prodhimit të energjisë elektrike prej 14,700, 000 kWh.vit...”.

Në pikën 2.b. fjalët “...sipas projektit të propozuar...” zëvendësohen me “...sipas kësaj marrëveshjeje...”

Neni 10

Ndryshimet dhe shtesat e përcaktuara në këtë marrëveshje hyjnë në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Nenet e tjera të kontratës bazë nuk kanë ndryshuar.

Kjo marrëveshje u hartua në 6 (gjashtë) kopje dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noterja e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

Palët

AUTORITETI KONTRAKTUES
MINISTRIA E EKONOMISË TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
PËRFAQËSUAR NGA Z.DRITAN PRIFTI

KONCESIONARI
SHOQËRIA "BUSA" SH.P.K.
PËRFAQËSUAR NGA Z. BUJAR ÇETA

PREVENTIVI PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE STRELCA 1 DHE 3

ANEKSI 1

Tabela përmbledhëse e preventivit HEC-Strelca -1					
Nr.	Emërtimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi Lekë	Vlefëta Lekë
1	Vepra e marrjes	copë	2	50 000	100 000
2	Baseni i dekantimit	copë	2	30 000	60 000
3	Kanal derivacioni	ml	3000	45 000	135 000 000
4	Basen presioni	copë	1	50 000	50 000
5	Tubacioni i presionit	ml	1300	30 000	39 000 000
6	Godina e hidrocentralit	m ²	100	30 000	3 000 000
7	Linja elektrike		1	13 601 200	13 601 200
8	Turbina pelton&pajisjet N=1700 kw	kw	1700	32 615	55 446 122
			SHUMA		246 257 322

Tabela përmbledhëse e preventivit HEC-Strelca -3					
Nr	Emërtimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi lekë	Vlefëta lekë
1	Vepra e marrjes	copë	1	50 000	50 000
2	Baseni i dekantimit	copë	1	30 000	30 000
3	Kanal derivacioni	ml	3500	45 000	157 500 000
4	Basen presioni	copë	1	50 000	50 000
5	Tubacioni i presionit	ml	3500	30 000	105 000 000
6	Godina e hidrocentralit	m ²	100	30 000	3 000 000
7	Linja elektrike		1	20 586 800	20 586 800
8	Turbina pelton & pajisjet N=2400 kw	kw	2400	32 615	78 276 878
			SHUMA		364 493 678

	Punime ndërtimore			Lekë	477 028 000
	Punime makineri pajisje (4100 KW)			Lekë	133 723 000
	Investimi total		TOTAL	Lekë	610 751 000

ANEKSI 2

GRAFIKU PËRMBLEDHËS I PUNIMEVE PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE STRELCA 1 DHE 3

Koha e vënies në shfrytëzim të hidrocentraleve (38 muaj)

Objekti i ndërtimit	Viti 1						Viti 2						Viti 3					
	60	120	180	240	300	360	420	480	540	600	660	720	780	840	900	960	1020	1080
HEC-1	VEPËR MARRJE, DEKANTUS, BASEN PRESIONI TRASEJA SEG 1																	
	TRASEJA SEG 2																	
	NDËRTESTA E CENTRALIT																	
	VEPËR MARRJE, DEKANTUS, BASEN PRESIONI TRASEJA SEG 1																	
	TRASEJA SEG 2																	
HEC-2	NDËRTESTA E CENTRALIT																	
	VEPËR MARRJE, DEKANTUS, BASEN PRESIONI TRASEJA SEG 1																	
	TRASEJA SEG 2																	
LINJA E TRANSMISIMIT																		

Shuma totale e investimit 601751000 lekë

Ndërtimi do të përfundojë për 38 muaj.

VENDIM
Nr.474, datë 30.6.2010

PËR RRRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rritjen në masën 4 për qind të:

a) pensioneve të plota, të pjesshme dhe të parakohshme të pleqërisë, pensioneve për merita të veçanta dhe për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar pensionet e caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) shtesës mujore, të përfituar në përputhje me vendimin nr.326, datë 21.6.1993 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”;

ç) pensioneve të caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994, të Presidentit “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”, miratuar me ligjin nr.7799, datë 24.2.1994;

d) shtesës mbi pension, të dhënë në përputhje me nenin 33 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Rritjen në masën 6 për qind të pensioneve të plota, të pjesshme dhe të reduktuara të invaliditetit, të invaliditetit nga aksidente në punë dhe sëmundje profesionale dhe të pensioneve familjare, të caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 3.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar pensionet e caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Rritjen në masën 6 për qind të shtesave mbi pension, të dhëna në përputhje me nenet 38, 39 dhe 48 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me nenin 24 të ligjit nr.4171, datë 13.6.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”.

4. Rritjen, në masën 10 për qind të:

a) pensioneve të plota dhe të pjesshme të pleqërisë, të pensioneve të invaliditetit dhe pensioneve familjare, të caktuara në përputhje me ligjin nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

b) pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të cilat pas kësaj rritjeje nuk mund të jenë më të larta se 10 690 (dhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj, që është shuma bazë e pensionit.

5. Rritjen, sipas përcaktimeve të pikave 1, 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi, e përfitojnë edhe pensionet të cilat caktohen nga data 1 korrik 2010 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit apo trajtimit, të jetë deri më 30 qershor 2010, përfshirë edhe këtë datë.

6. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të këtij ligji, që kanë datë fillimi nga 1 korriku 2010 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 10 690 (dhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj dhe më shumë se 21 380 (njëzet e një mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë në muaj.

7. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1 korriku i vitit 2010 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 6980 (gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë në muaj, por jo më shumë se 10 690 (dhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj, që është shuma bazë e pensionit.

8. Pensionistët që përfitojnë pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, të caktuara sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, edhe pas rritjes së pensionit të përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e të ardhurave, sipas kritereve dhe masës së përcaktuar në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.401, datë 21.6.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr.763, datë 27.12.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve” dhe nr. 415, datë 27.4.2009 “ Për rritjen e pensioneve”.

9. Pensionistët që përfitojnë pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, të caktuara sipas ligjeve nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”; dhe sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, edhe pas rritjes së pensionit në masën e përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e të ardhurave në masën e përfituar nga zbatimi i vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.17, datë 20.1.2007 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”.

10. Pas rritjes së pensionit sipas përcaktimeve të shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, kompensohen me:

a) 200 (dyqind) lekë në muaj, pensionistët që përfitojnë pension të plotë pleqërie minimal, të caktuar sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kur të ardhurat mujore nga pensioni dhe nga kompensimet, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 21.6.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr.763, datë 27.12.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr.138, datë 31.3.1994 “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, nr.471, datë 15.7.1996 “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajurit dhe gazit të lëngshëm”, dhe nr. 415, datë 27.4.2009 “Për rritjen e pensioneve”, janë deri në 12 640 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet) lekë. Pas përfitimit të këtij kompensimi të ardhurat minimale rezultojnë të rritura me 6 për qind;

b) deri në 200 (dyqind) lekë në muaj, por në përpjesëtim të pensionit individual me pensionin e plotë minimal, pensionistët që përfitojnë pension të pjesshëm pleqërie, të caktuar sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kur masa e pensionit të pjesshëm është deri në 10 689 (dhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë në muaj. Këta pensionistë do të vazhdojnë të përfitojnë kompensimin e llogaritur sipas vendimeve të 4028

Këshillit të Ministrave nr.401, datë 21.6.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr.763, datë 27.12.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr.138, datë 31.3.1994 “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, nr. 471, datë 15.7.1996 “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”, dhe nr. 415, datë 27.4.2009 “Për rritjen e pensioneve”;

c) deri në 200 (dyqind) lekë në muaj, pensionistët që marrin pension pleqërie qyteti më të lartë se pensioni minimal, kur masën e pensionit pas rritjes plus kompensimet, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave, nr. 401, datë 21.6.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr.763, datë 27.12.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr.138, datë 31.3.1994 “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, nr.471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”, dhe nr.415, datë 27.4.2009 “Për rritjen e pensioneve”, e kanë nga 12 641 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e një) deri në shumën 12 840 (dymbëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet) lekë në muaj.

11. Kompensimin deri në 200 (dyqind) lekë në muaj e përfitojnë edhe pensionistët që do të marrin pensione pleqërie, pensione invaliditeti dhe pensione familjare, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96 të këtij ligji, me datë fillimi nga 1 korriku i vitit 2010 e në vazhdim, kur shuma e të ardhurave mujore që lidhen me pensionin e plotë është deri në 12 840 (dymbëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet) lekë.

12. Pas rritjes së pensioneve sipas pikave 1 e 4 dhe zbatimit të kompensimeve sipas pikave 10 e 11 të këtij vendimi, të ardhurat minimale nga pensionet e plota të pleqërisë në qytet nuk mund të jenë më të vogla se 12 840 (dymbëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet) lekë në muaj, ndërsa të ardhurat minimale nga pensionet e plota në fshat nuk mund të jenë më pak se 7870 (shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë në muaj.

13. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përlllogariten në shumën prej 1912 milionë lekësh dhe përballohen nga fondi i kontingjencës, i caktuar në Buxhetin e Shtetit të vitit 2010, për rritjen e pensioneve.

14. Shpenzimet për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare, sh.a., për 0.75 për qind në muaj, përlllogariten në shumën 14 milionë lekë dhe përballohen nga fondi i kontingjencës, i caktuar në Buxhetin e Shtetit të vitit 2010.

15. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare, sh.a., për nxjerrjen e udhëzimeve teknike dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.476, datë 30.6.2010

PËR RITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARAKËVE, TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT DHE TË TRAJTIMEVE TË VEÇANTA FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10 142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të

Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruer të nëndetëseve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension”, të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, dhe të ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rritjen, në masën 4 për qind, të:

a) pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, të pensioneve suplementare të pleqërisë, të pensioneve suplementare të invaliditetit, të pensioneve suplementare të invaliditetit të ushtarakëve që, për shkak të detyrës, bëhen plotësisht të paaftë për shërbim, të pensioneve suplementare familjare, të pensioneve suplementare familjare të ushtarakëve, që kanë humbur jetën për shkak të detyrës, të caktuara me ligjin nr.8087, datë 13.3.1996, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, dhe ligjin nr.8661, datë 18.9.2000, “Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar me ligjin nr.10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakut të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”;

b) trajtimit të veçantë financiar të familjeve të pilotëve fluturues, të caktuara me ligjin nr.8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar;

c) trajtimit të veçantë financiar të pilotëve fluturues sipas ligjit nr. 9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”;

ç) trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr.9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruer të nëndetëseve dhe polumbarëve të forcave detare, në pension”;

d) trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të caktuara sipas ligjit nr.8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar;

dh) trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”;

e) pensioneve suplementare, të caktuara sipas ligjit nr.10 139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, të Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë.”.

2. Rritjen, në masën 4 për qind, do ta marrin edhe të gjitha përfitimet e përcaktuara në pikën 1, kur caktohen pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, por me datë fillimi të së drejtës deri më 30.6.2010, përfshirë edhe këtë datë.

3. Efektet financiare, për vitin 2010, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të llogariten në shumën 98 420 mijë lekë dhe të përballohen nga fondi i kontigjencës, i caktuar në buxhetin e shtetit të vitit 2010, për rritjen e pensioneve.

4. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.477, datë 30.6.2010

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.1114, DATË 30.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE NR.7703, DATË 11.5.1993 “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, NR.9136, DATË 11.9.2003 “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, DHE NR.7870, DATË 13.10.1994 “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1114, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 e kreut II ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, nga data 1.7.2010 e në vazhdim, të jetë jo më pak se 16 820 (gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet) lekë, ndërsa paga maksimale mujore të jetë 84 100 (tetëdhjetë e katër mijë e njëqind) lekë.

2. Pikat 1, 2, 6, 7, 9, 10, 11 e 13, të kreut III, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Shuma minimale mujore e kontributeve, për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën nga data 1.7.2010 e në vazhdim, të jetë 4 693 (katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë. Kontributi minimal mujor, sipas degëve të sigurimit, të jetë:

	%	në lekë
- Dega e sigurimit të sëmundjeve	0.3	51;
- Dega e sigurimit të barrë lindjeve	1.4	235;
- Dega e sigurimit të pensioneve	21.6	3 633;
- Dega e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale	0.3	51;
- Dega e sigurimit të papunësisë	0.9	151;
- Sigurimet shëndetësore	3.4	572.

2. Shuma minimale mujore e kontributit të sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarin dhe për pjesëtarët e familjes, të patrajtuar me pagë, të jetë 7 për qind e pagës minimale mujore, e barabartë me 1 177 (një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.”.

...

“6. I vetëpunësuar, i vetëpunësuar në ortakëri, i vetëpunësuar, që punëson të tretë (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.7.2010 e në vazhdim, paguan për vete një kontribut të detyrueshëm, për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 30 për qind (23 për qind, sigurim shoqëror, dhe 7 për qind, sigurim shëndetësor të pagës mujore minimale, prej 16 820 (gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet) lekësh, të barabartë me 5 046 (pesë mijë e dyzet e gjashtë) lekë në muaj.

7. I vetëpunësuar, për pjesëtarët e familjes së tij, mbi 16 vjeç, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të ligjërishit (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.7.2010 e në vazhdim, paguan kontribut të detyrueshëm për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 30 për qind (23 për qind, sigurim shoqëror, dhe 7 për qind, sigurim shëndetësor) të pagës mujore minimale prej 16 820 (gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet) lekësh, e barabartë me 5 046 (pesë mijë e dyzet e gjashtë) lekë në muaj.”.

...

“9. Personat e vetëpunësuar në veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante, nga data 1.7.2010 e në vazhdim, të deklarojnë dhe të paguajnë kontribut minimal mujor, në shumën 1 440 (një mijë e katërqind e dyzet) lekë.

10. Personat mbi 16 vjeç, me të ardhura të rregullta nga pronësia, e që nuk janë të punësuar diku tjetër, duke filluar nga 1.7.2010 e në vazhdim, të paguajnë kontribut vetëm për sigurimin shëndetësor, në masën 7 për qind të pagës mujore minimale, prej 16 820 (gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet) lekësh.

11. Të vetëpunësuarit në bujqësi, nga data 1.7.2010 e në vazhdim, të derdhin kontribut vjetor për sigurimet shoqërore, në masën 17 280 (shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë, me përjashtim të të vetëpunësuarve, që banojnë në rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilët masa e kontributit vjetor është 11 232 (njëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e dy) lekë.”.

...

“13. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore, për personat, që punojnë si punëtorë shtëpie, nga data 1.7.2010 e në vazhdim, të jetë 1 440 (një mijë e katërqind e dyzet) lekë në muaj.”.

3. Pikat 2 e 4, të kreut IV, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2. Punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar, që e fillojnë veprimtarinë për herë të parë, paraqesin, në agjencitë e sigurimeve shoqërore, kopjen e certifikatës së identifikimit të personit të tatueshëm dhe regjistrimi bëhet sipas procedurës së përcaktuar në udhëzimin e ministrit të Financave. Pas pajisjes së shtetasve me letërnjoftimin elektronik, numri i sigurimit shoqëror zëvendësohet me numrin personal të identifikimit.” .

...

“4. Personat e vetëpunësuar për herë të parë, në veprimtari, tregtare a shërbimi, ambulante, paraqesin, në agjencitë e sigurimeve shoqërore, kopjen e certifikatës së identifikimit të personit të tatueshëm dhe regjistrimi bëhet sipas procedurës së përcaktuar në udhëzimin e ministrit të Financave. Pas pajisjes së shtetasve me letërnjoftimin elektronik, numri i sigurimit shoqëror zëvendësohet me numrin personal të identifikimit.”.

4. Pas shkronjës “b”, të pikës 6/1, të kreut IV, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) periudhat nga data 1.9.1995 deri në datë 1.4.2006, për të cilat të vetëpunësuarit në bujqësi kanë paguar kontribute deri në datën 21.12.2009, të cilët vendbanimin e kanë në të njëjtin rreth ku kanë tokën, për rastet, kur toka është blerë, sipas ligjit nr.7983, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e tokës bujqësore, livadheve dhe kullotave”, si dhe për rastet, kur toka është marrë me qira, me akt noterial.”.

5. Pika 5 e kreut V, shfuqizohet.

6. Pika 5 e kreut VI, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Për subjektet, juridike dhe fizike, përveç personave të vetëpunësuar në bujqësi, shuma e detyrimit kontributiv dhe e interesave llogaritet, evidentohet dhe administrohet nga administrata

tatimore, e cila është përgjegjëse edhe për vjeljen e detyrimeve të prapambetura, që këto subjekte kanë ndaj sigurimeve shoqërore. Për subjektet debitore aktive me detyrime të prapambetura në organet e sigurimeve shoqërore dhe të paarkëtuara deri më 1.7.2010 të bëhet transferimi i detyrimeve të prapambetura të tyre në organet tatimore.”.

7. Në fund të shkronjës “a”, të pikës 1, të kreut VII, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Të dhënat mujore për detyrimet për kontributet e papaguara në afat për çdo subjekt, si dhe për kreditorët, për kontribute të paguara më tepër se detyrimi i llogaritur deri në datën 28, të muajit pasardhës dhe deri në datën 28 të muajit pasardhës, pas mbylljes së tremujorit, për të vetëpunësuarit privatë, sipas formatit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.”.

8. Kreu VIII ndryshohet, si më poshtë vijon:

“VIII. SHUMA BAZË E PËRFITIMEVE

1. Në mbështetje të neneve 2, 32, 36 e 48, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit nga data 1.7.2010 e në vazhdim, të jetë 10 690 (dhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj.

2. Në mbështetje të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma e përfitimit, për personat, që nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e masës së pensionit, të përcaktuar në paragrafin e parë, të këtij neni, nga data 1.7.2010 e në vazhdim, të jetë 6 980 (gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë në muaj.

3. Në mbështetje të pikës 4 të nenit 27 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit për gratë, të cilat e kanë periudhën e fundit të sigurimit si të vetëpunësuarat në bujqësi, nga data 1.7.2010 e në vazhdim, të jetë 6 980 (gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë në muaj.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 1.7.2010

Doli nga shtypi më 1.7.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë